

W
P



UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare e Kuvendit të Kosovës
Nr. 02-58/19-07
Prishtinë, më 30 korrik 2007
Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë.
Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 81 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE

- 1. Debat për procesin politik lidhur me vazhdimin e zgjidhjes së statusit të Kosovës**

Kryetari i njoftoi deputetët e pranishëm se anëtarët e Grupit Negociator, në bazë të kërkesës së Kuvendit, kanë shprehur gatishmëri të marrin pjesë në debatin e sotëm për procesin politik lidhur me vazhdimin e zgjidhjes së statusit të Kosovës

Ai e ftoi kryetarin e Kosovës ta marrë fjalën.

Kryetari i Kosovës, dr. **Fatmir Sejdiu**, tha se në emër të Ekipit të Unitetit do t'ju njoftoj shkurtimisht me zhvillimet kryesore që kanë të bëjnë me përcaktimin e statusit politik të Kosovës, si dhe me kahet kryesore që do t'i përcjellim bashkërisht për ta përfunduar sa më shpejt këtë proces të rëndësishëm dhe jetik për Kosovën.

Nga marsi i këtij viti, kur Kuvendi i Kosovës mbështeti propozimin gjithëpërfshirës të presidentit Ahtisari, janë bërë zhvillime të shumta politike në skenën ndërkombëtare.

Propozimi i presidentit Ahtisari, i proceduar në Këshillin e Sigurimit, krahas mbështetjes që ka marrë nga Bashkimi Evropian dhe mekanizmat e tjerë evropian, është mbështetur edhe nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, zotit Ban Ki Mun dhe të shumicës së vendeve anëtare të Këshillit të Sigurimit. Për fat të keq, përkundër përpjekjeve të vazhdueshme dhe jashtëzakonisht intensive të shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të vendeve anëtare të Këshillit të Sigurimit nga Bashkimi Evropian që nëpërmjet rezolutave të bashkëspozoruara nga ato të përmbyllin këtë proces me miratimin e një rezolute të re që do ta mbështeste këtë propozim, për shkak të bllokimit të vazhdueshëm me kërcënime me veto nga ana e Federatës Ruse, pas pesë projektrezolutave nuk u hodh në votim një tekst përfundimtar.

Ekipi i Unitetit, duke përcjellë me vëmendje gjithë këto zhvillime dhe duke shprehur shqetësimin e vet të institucioneve dhe të popullit të Kosovës për këto pengesa të pajustificueshme, gjatë gjithë këtyre muajve ka zhvilluar një aktivitet të gjerë e të gjithanshëm diplomatik me qëllim të argumentimit dhe të sigurimit të mbështetjes tek të gjitha vendet anëtare të Këshillit të Sigurimit për pavarësinë e Kosovës.

Ekipi i Unitetit gjatë kësaj periudhe ka intensifikuar aktivitetin e tij sidomos në kontaktimin e vendeve anëtare të Këshillit të Sigurimit nga Bashkimi Evropian si dhe me zyrtarët më të lartë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Duke parashikuar paperspektivën e kapërcimit të një rezolute, që do të mbështeste propozimin e Ahtisarit në Këshillin e Sigurimit, këta faktorë kanë propozuar qasjen alternative në një proces të ri të angazhimeve për të siguruar mbështetjen e propozimit të Ahtisarit dhe njohjen e koordinuar të pavarësisë së Kosovës pas një angazhimi shtesë prej 120 ditësh.

Ekipi i Unitetit, duke i analizuar në thellësi të gjitha këto zhvillime ka shprehur gatishmërinë e tij që të kontribuojë në këtë proces të ri të angazhimeve, pra në këtë qasje alternative për të përmbyllur procesin e pavarësimit të Kosovës.

Duke pasur parasysh Rezolutën e Kuvendit të Kosovës lidhur me procesin e definimit të statusit politik të Kosovës, të majit 2005, duhet theksuar në veçanti:

1. Në këtë proces të angazhimeve shtesë në nivelin e Grupit të Kontaktit, Kosova ua ka bërë me dije të gjithë faktorëve relevantë ndërkombëtarë se pavarësia e Kosovës është e panegociueshme.
2. Integriteti territorial dhe funksional i Kosovës është i pacenueshëm. Kosova është unike dhe e pandarë.
3. Propozimi i gjithëpërfshirës i Presidentit Ahtisari konsiderohet dokument i përfunduar dhe i mbyllur për ne dhe si i tillë nuk mund të hapet e as nuk mund të negociohet.